




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË



Nr. 316 Prot.

Tiranë, më 16.03.2018

Nr. 1040 Dosje

V E N D I M
PËR PËRCAKTIMIN E OBJEKTIT TË SEKUESTROS

Drejtuar : QENDRËS KOMBËTARE TË BIZNESIT (QKB – TIRANË)

Unë, Altin Vako , me detyrën e Përmbauesit Gjyqësor, në referim të Urdhërit të Ekzekutimit Nr. 1490 (31134-05551-80-2017) Regj.Them, të lëshuar më datë 21.09.2017 prej Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, kam vënë në ekzekutim këtë urdhër, duke regjistruar në dosjen përmbaimore Nr. 1040, Datë 22.02.2018 kërkesën e kreditorit Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit I.K.M.T (ish – I.N.U.K), ndaj debitorit Shoqëria “PALUCA – Sa” Sh.p.k, në lidhje me titullin ekzekutiv, Vendim për Dënim me Gjobë Nr. 06, datë 26.01.2016.

Pasi fillova procesin e ekzekutimit të detyrueshem, duke i dërguar debitorit lajmërimin Nr. 202 Prot, Datë 22.02.2018 për të ekzekutuar vullnetarisht detyrimin që përmban urdhëri i ekzekutimit Nr. 1490 (31134-05551-80-2017) Regj.Them, Datë 21.09.2017, në referim të neneve 517 dhe 518 të K.Pr.Civile,

KONSTATOJ

Se debitori Shoqëria “PALUCA – Sa” Sh.p.k, ka marrë njoftimin e Lajmërimit për Ekzekutimin Vullnetar të Detyrimit, dhe nuk i është pergjigjur respektimit të afatit dhe kërkesave të këtij lajmërimi.

Në këto kushte në referim të nenit 527 të K.Pr.Civile duhet të filloj ekzekutimin e detyrueshëm, duke vënë sekuestër duke vënë sekuestër mbi aksionet te debitorit Shoqërisë “PALUCA – Sa” Sh.p.k dhe Z. Sandër Paluca (në cilësinë e administratorit të Shoqërisë “PALUCA – Sa” Sh.p.k) në masen që do të jetë e nevojshme për plotësimin e detyrimit.



